VENDIM
Nr. 694, datë 2.10.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 686, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së planifikimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 15, shtohet pika 15/1 me këtë përmbajtje:
"15/1 "Konsolidim urban", është procesi i densifikimit dhe i mbushjes urbane të njësisë strukturore apo të një a më shumë pjesëve të saj, të cilat janë të zhvilluara në mënyrë homogjene, sa u përket kushteve të zhvillimit, ndërtimeve në territor, si dhe rrjetit rrugor e infrastrukturor.".

Neni 2

Pika 1 e nenit 11, ndryshohet si më poshtë vijon:
"1. Rishikimi i dokumentit të planifikimit kryhet në përputhje me nenin 26, të ligjit, për shkak të forcave madhore, si: tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj., të ngjashme, për shkak të ndarjeve administrative e territoriale, ndryshimeve të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshimeve të shkaktuara nga kriza sektoriale, si edhe kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.".

Neni 3

Pika 1, e nenit 22, ndryshohet si më poshtë vijon:
"1. Planet kombëtare sektoriale hartohen nga ministritë, me qëllim zhvillimin strategjik të një ose më shumë sektorëve, sipas fushave të kompetencës, si:
a) siguria kombëtare;
b) mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore, të lidhura me: sizmicitetin, hidrogjeologjinë, hidrografinë, gjeologo-inxhinierinë, ndryshimet klimatike etj.;
c) energjia;
ç) industria;
d) transporti;
dh) infrastruktura;
e) turizmi;
ë) zonat detare dhe infrastruktura e ujit;
f) zonat ekonomike;
g) arsimi;

gj) sporti;
h) trashëgimia kulturore dhe natyrore;
i) burimet natyrore;
j) shëndetësia;
k) bujqësia etj.”.

Neni 4

Shkronja “f”, e pikës 2, të nenit 82, ndryshohet si më poshtë vijon:
“f) zhvillimet në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, tërmete, përmbytje, zjarre masive, rrëshqitje të tokës, erozion etj.”.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama